



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:074565

Datë: 03.12.2020

Numri i dokumentit: 01316093

P.nr.369/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit S. H nga ..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.885/20, të datës 23.06.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 17.11.2020, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 03.12.2020 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri S. H, nga babai S... dhe nëna H..., e lindur M..., i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna e Lipjanit ndërsa me vendbanim në .... rruga "...", numër 19, ka të kryer shkollën fillore, pensioner, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 03.09.2019, në shtëpinë e tij në .... i pandehuri, si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur energji elektrike, ashtu që nga ekipa profesionale e KEDS-it, gjatë kontrollës është inspektuar (pika matëse) ku është hasur –identifikuar se shtëpia është kyçur direkt në rrjetin elektrik, ku me këtë veprim është anashkaluar njehsori elektrik i cili bënë matjen e shpenzimit të kilovatëve të energjisë elektrike, ku me këtë veprim i pandehuri ka bërë harxhim të paautorizuar të energjisë elektrike, të dëmtuarës KEDS –in, Distrikti në ... i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 84.24 euro.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së,

andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 326 e 365 të KPP-ës, të pandehurit S.H:

## E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara KEDS-Distrikti në ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 23.06.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.885/2020, kundër të pandehurit Sali Halili, për shkak veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me datë 17.11.2020, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezente prokurori i shtetit dhe i pandehuri, me ç'rast pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e kishte kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njëjti kishte deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndor andaj gjykata pas dëgjimit të palëve kishte marrë aktvendim me të cilin të pandehurit ia kishte pranuar pranimin e fajësisë.

### 2.Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 326 lidhur me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza përkatësisht në procesverbalin me numër ... i datës 03.09.2019, një fotografi nga vendi i ngjarjes, procesi nga Sektori i Rikthimit të Humbjeve, Distrikti në Gjilan me ID e rastit ...i datës 05.09.2019 dhe Fatura DGLHP ..., gjithashtu gjykata konstatoi se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri S.H nga Gjilani ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzet) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij dhe ka kërkuar falje për veprimet e tij, gjendja e tij ekonomike është e dobët faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njëjti bie ndesh ligjin ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë andaj gjykata konsideron dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit po ashtu gjykata konsideron se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### 5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarën KEDS, e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

### 6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet) euro si shumën prej 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.369/20, me datë 03.12.2020

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.